

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	U propozua dy javë më parë për President të Kosovës, Bekim Sejdiu tërhiqet nga kandidatura: Më ka munguar mbështetja parlamentare
ADRESA	https://newsbomb.al/rajon/u-propozua-dy-jave-me-pare-per-president-te-kosoves-bekim-sejdiu-terhiqet--i401199
BURIMI	newsbomb.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	14 shtator 2026, 17:24:22 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	14 shtator 2026, 17:21:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	4809c111a0fb84067be1fa496e60b8dfcef142ccca3fc773e0463a0957f34733
TEKSTI	8d0f694c8b97a7398cb5b47fd22717c60f5878691408c2e3ecf7f26a08b39b02
PAMJA	e74422997e0387bd7d144342bda03aa90ae7fa0ca9a8f523269ddf347be3de30

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	a2af63e1a6006e757c73ed1df85440605a4727f4f74ffa62abec5d07665c5263
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	7d10e546d6131736d6471679d3f791247cbf6360c575f31a51d509cf567f1bfc
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/a2af63e1a6006e757c73ed1df85440605a4727f4f74ffa62abec5d07665c5263

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

12 numrat e parë FALAS!
Version PDF

Abonohu te Revista

Kreu Politikë Aktualitet Ekonomi Kulturë & Art Rajon Sport Bota Showbiz SocialBomb



Çështjet kryesore

Arrestohet Ergys Agasi

"Retreat"-i i qeverisë në Pogradec!

SPAK godet grupin e Eldi Dizdarit dhe Dritan Gjikës

Rajoni

14 Shtator 2026, 19:21

U propozua dy javë më parë për President të Kosovës, Bekim Sejdiu tërhiqet nga kandidatura: Më ka munguar mbështetja parlamentare



Shkruar nga Newsbomb



Bekim Sejdiu

Bekim Sejdiu ka njoftuar përmes një postimi në rrjete sociale se është tërhequr nga kandidatura për president të Republikës së Kosovës.

Përmes një postimi të bërë në Facebook, ai është shprehur se kishte pranuar kandidaturën me qëllim për t'i shërbyer zhbllokimit të ngërçit institucional dhe për të kontribuar në krizën që po kalon së fundmi vendi.

Sejdiu ka bërë të ditur se në rrethanat e krijuar dhe mungesa e mbështetjes së nevojshme parlamentare për zgjedhjen e tij si president është përfshirë me dinamikë dhe përplasje të brendshme politike dhe për këtë arsyeje ka vendosur të tërhiqet nga kandidatura.

"Në rrethanat e krijuara, të karakterizuara nga mungesa e mbështetjes së nevojshme parlamentare për zgjedhjen time si Presidentit dhe nga devijimi i tërë procesit në vorbullën e dinamikave dhe përplasjeve të brendshme politike, kam vendosur të tërhiqem nga kandidatura për President të Republikës së Kosovës," thekson ai.

Gjithashtu ai është shprehur se për vendimin e marrë ka njoftuar më herët përfaqësuesit e Lidhsjes Demokratike të Kosovës dhe të Lëvizjes Vetëvendosje.

Revista



Abonohu tani dhe lexoje >

Lajmet e fundit



Showbiz & Lifestyle

"Këtë, e kam jetë të dytë", gazetari Bledi Strakosha flet për sëmundjen e tij: Është vdekjeprurëse, 50% e njerëzve nuk arrijnë as të...



Aktualitet

Dy shqiptarët vënë në "lojë" sigurinë e policisë greke, njëri u mor me armë nga spitali, tjetri nuk u kthye nga leja! Autoritetet në kërkim të korçarit dhe Alket Rizait

Zbulu më shumë artikuj >

Postimi i plotë:

Të dashur qytetarë të Republikës së Kosovës, të dashur miq!

Para dy javësh u kontaktova nga përfaqësues të Lidhjes Demokratike të Kosovës, nga të cilët u ftova në një takim të përbashkët me delegacionet e kryesura nga liderët e Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe të Lëvizjes Vetëvendosje. Aty u njoftova se, pas një procesi shterues bisedimesh, këto dy parti kanë arritur pajtueshmëri që emri im të propozohet si kandidat jopartiak për President të Republikës së Kosovës.

E konsideroj këtë si besim të madh ndaj meje si person dhe një vlerësim për kontributin tim në jetën institucionale të Republikës së Kosovës.

Përfaqësueset e këtyre dy partive ua shpreh mirënjohjen time më të thellë, që më kanë nderuar me një besim të tillë dhe për mbështetjen e tyre përgjatë këtij procesi.

Duke qenë i vetëdijshëm për periudhën e vështirë nëpër të cilën po kalon vendi ynë dhe për rrezikun që kriza institucionale të thellohet, kam pranuar të jem kandidat për President të Republikës së Kosovës.

Komoditetin personal dhe indiferencën intelektuale nuk i kam konsideruar asnjëherë opsione kundruall nevojës për t'i shërbyer vendit, sidomos në situata krizash. I kam qëndruar gjithmonë idesë se intelektualët dhe profesionistët kanë përgjegjësi ndaj shoqërisë dhe se kapacitetet intelektuale dhe aftësitë e tyre profesionale nuk kanë asnjë vlerë nëse nuk vihen në shërbim të interesit të përgjithshëm.

Siç e kam thënë edhe në paraqitjen time publike, nuk kam pasur asnjë ambicie për pozita publike përtej atyre akademike dhe profesionale dhe motivi im i parë dhe i vetëm për ta pranuar propozimin për postin e Presidentit të shtetit ka qenë që të vihem në shërbim të zhblokimit të ngërçit institucional.

Kam besuar se partitë politike parlamentare dhe deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës do të gjejnë forcë për t'i tejkaluar ndasitë politike ose çfarëdo interesi tjetër, për t'i dhënë vendit institucione stabile në këto kohë të vështira dhe me plot sfida.

Në rrethanat e krijuara, të karakterizuara nga mungesa e mbështetjes së nevojshme parlamentare për zgjedhjen time si Presidentit dhe nga devijimi i tërë procesit në verbullën e dinamikave dhe përplasjeve të brendshme politike, kam vendosur të tërhiqem nga kandidatura për President të Republikës së Kosovës. Për këtë vendim timin i kam njoftuar më herët përfaqësuesit e Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe të Lëvizjes Vetëvendosje.

Mbështetja e gjerë që më është ofruar këto ditë, nga kolegë, miq, personalitetet publike e të shoqërisë civile dhe, në mënyrë të veçantë, nga mërgata shqiptare në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, më ka bërë krenar për punën time në shërbim të Republikës së Kosovës.

Kjo ma përforcon besimin e patundur se lojalitetin institucional dhe patriotizmin kushtetues i kam pasur gjithmonë si udhërrëfyesit e vetëm në angazhimin tim institucional. Atë përcaktim, sidomos në mbrojtje të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, asnjëherë nuk e kam pasur selektiv apo konjunktural, por parimor dhe profesional.

Republika e Kosovës dhe qytetarët e saj nuk kanë nevojë për drama politike dhe thellim të polarizimit, por për maturi dhe bashkim në funksion të forcimit të shtetit tonë.

Prandaj, me sinjeritetin më të madh shpresoj se partitë politike do të gjejnë rrugëdalje nga ky rreth vicioz, i cili, më shumë se çdo gjë tjetër, po e venitë shpresën e qytetarëve për një të ardhme prosperuese për ta dhe familjet e tyre.

Republika e Kosovës është shtëpia jonë e përbashkët, e lindur nga ideale të pathyeshme dhe sakrificë sublime. Kosova qëndron mbi çdonjërin prej nesh, ndaj, së bashku, ia kemi borxh t'i shërbejmë me devotshmëri, gjithmonë, kurdo dhe pa asnjë kusht.

Sondazh

Poll

Lexo gjithashtu



E Hënë 17:46

Mes lotëve dhe dhimbjes, i jepet lamtumira e fundit nga miqtë dhe kolegët Giorgos Mazonakis



Rajoni

Tragjedi në jug të Greqisë, përmytet varka me emigrantë, 1 i vdekur dhe 20 të zhdukur

E Hënë 15:21



Rajoni

Seanca maratonë për Thaçin dhe katër miqtë e tij, DATA e përafërt kur mund të çohen në qeli ose jo për bashkëpunim kundër drejtësisë

E Hënë 15:18 Newsbomb



E Hënë 14:41 Newsbomb

KËRCËNOHET me jetë kryeministri i Maqedonisë së Veriut, nën hetim 39-

vjeçari nga Çerkezi



Rajoni

"Liri për çlirimtarët!" Shkupi mbledhet nesër në mbështetje të ish-krerëve të UÇK-së (ORA-VENTI)

🕒 E Hënë 13:51



Rajoni

Avokatët e Thaçit "shuplakë" prokurorëve të Hagës: Provat e mbledhura janë të paqarta! Keni gjetur dokumente të redaktuara në qese plehrash

🕒 E Hënë 13:11 Newsbomb



🕒 E Hënë 12:32 Newsbomb

ZBULOHEN tri gjyqtarët që kanë në dorë fatin e Hashim Thaçit, Prokuroria e Hagës e do në burg për 6 vite për pengim drejtësie



Rajoni

Seanca që pritet të VULOSE fatin e Hashim Thaçit, Prokurorët e Hagës nuk heqin dorë nga kërkesa për burg, PROVA të reja për pengim drejtësie

🕒 E Hënë 11:44 Newsbomb




Rajoni

Protesta e radhës për lirin e ish-krerëve të UÇK-së, ambasada e ShBA-ve në Prishtinë sugjeron shmangien e zonës, pezullohet mësimi (DATA-DETAJE)

🕒 E Hënë 11:27 Newsbomb





🕒 E Diel 23:45

Kurti prezanton Qeverinë e re dhe programin 4-vjeçar: Pagë mesatare mbi 1000 euro, pensionistët që kujdesen për nipërit 100 euro shtesë

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.